

NEWSLETTER

Shkurt

**Kostoja e dashurisë,
sa i kushton “Shën Valentini”
klientëve të Albsig?**

**Albsig, prej 20 vitesh pranë
jush me 30 degë në të gjithë
Shqipërinë.**

**Youth/Kids, paketa e
sigurimit që mbron buxhetin
e cdo familje për sigurimin e
fëmijëve dhe të rinjve.**

**Merrni paketën e sigurimit
Youth/Kids menjëherë për ju
dhe fëmijët tuaj!**

 **ALBSIG**

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



Kostoja e dashurisë, sa i kushton “Shën Valentini” klientëve të Albsig?

Ashtu siç ndodh çdo vit, edhe këtë Shën Valentin, qindra çifte festuan në mënyra nga më të ndryshmet, ku zgjedhjet janë nga më të larmishmet. Përveç luleve, ëmbëlsirave, një darkë në një restorant dhe më pas dhurata. Ajo përfshin shumë sektorë, duke filluar nga kujdesi personal, deri te veshjet, udhëtimet, një kupon për t’u shpenzuar diku, bizhuteri etj. Më të privilegjuarat janë femrat, por nuk mungojnë edhe dhuratat për meshkujt. Edhe këtë Shën Valentin Albsig ka menduar jo vetëm për çiftet e dashuruara por edhe për ata që ju qëllon sigurimi këtë ditë të shënuar.

“Sigurimi i plotë në dorën tuaj. Zgjidhni lirinë dhe sigurinë me paketat tona të personalizuar. Siguroje online tani dhe merr cmimet e favorshme!” Kjo është thirrja përmes rrjeteve sociale që Albsig njofton klientët për paketat e personalizuar me rastin e festës së të dashuruarve. “Sot sigurova, makinën dhe shëndetin e gjithë familjes dhe mora një çmim të favorshëm në ofertë. Paketat e personalizuar me rastin e festës janë shumë të favorshme për familjet e reja siç jam dhe unë”, u shpreh Ermir Kraja, një prej klientëve të Albsig. Ky i fundit shtoi se: Oferta Speciale për Shën Valentin është një ndër paketat më të kërkuara nga të gjithë! Me këtë mënyrë kombinimi, Albsig dhuron dashuri me një grup produktesh të personalizuar.

Albsig ka qenë dhe do të mbetet një nga shoqëritë e sigurimeve e cila është gjithmonë pranë klientëve të saj dhe jo vetëm, me oferta të personalizuar dhe benefite të krijuara për nevojat tyre! Dhe nuk mbetet gjë tjetër vetëm që të njoftohen të gjithë të interesuarit për t’u pajisur me sigurime në Albsig që: Nxitoni të përfitoni nga ofertat e dashurisë, sepse Albsig gjithmonë mendon për ju dhe të dashurit tuaj. Albsig ka krijuar të gjitha kushtet e favorshme jo vetëm me paketat e personalizuar por edhe përmes blerjeve online ju mund të kurseni kohë dhe para. Andaj nuk ju ngelet gjë tjetër vetëm të porosisni në www.albsig.al sigurimin që ju duhet dhe menjëherë do ta keni në shtëpinë tuaj.



Albsig, prej 20 vitesh pranë jush me 30 degë në të gjithë Shqipërinë.

Albsig, prej 20 vitesh është në treg dhe disponon një rrjet të konsoliduar shitjesh. Aktualisht Albsig disponon rreth 30 degë në të gjithë Shqipërinë me produktet e sigurimeve ndër më të mirat në treg dhe me shërbime në kohë rekord dhe me standard europiane. Misioni i Shoqërisë Albsig është të gjendet pranë klientit fundor, me produkte dhe shërbime, të cilat kanë besueshmëri të lartë dhe të jenë më kompetitivet në treg.

“Albsig, prej 20 vitesh pranë jush me 30 degë në të gjithë Shqipërinë”. Me ju, në çdo kohë dhe kudo”, thuhet në njërin prej njoftimeve në rrjetet sociale të kompanisë! Jo vetëm kaq por në njoftim thuhej se kompania ka arritur të lërë gjurmë të konsiderueshme në këtë sektor për shkak të strategjisë së fokusuar në krijimin e avantazheve konkurruese. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, ka ngritur më shumë se 30 degë në të gjithë Shqipërinë me staf të trajnuar, për t’u përgjigjur për çdo informacion, për të krijuar besueshmërinë ndaj klientëve. Orientimi i konsumatorëve dhe tregut në tërësi drejt produkteve vullnetare, është qëllimi dhe arritja kryesore në treg për Shoqërinë e Sigurimeve Albsig. Albsig është kompania e parë në treg për sigurimin e pronës, konkretisht për produktet (zjarr, vjedhjen inxhinierike). Rritja e vazhdueshme dhe konsolidimi i pozitave në tregun e sigurimeve, Albsig-ut i ka dhënë mundësinë që të jetë optimiste për planet në të ardhmen dhe shumë shpejt të jetë kryesuese në treg.

Falë arritjeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati, Albsig fokus investimesh ka infrastrukturën dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe investimin në kualifikimin dhe trajnimet e vazhdueshme të stafit. Që prej themelimit ALBSIG është ndër të paktat kompani në tregun e sigurimeve që ka ruajtur vazhdimisht një trend pozitiv në rritje dhe që vit pas viti ka konsoliduar pozitat në tregun e sigurimeve. Sigurisht, kjo rritje e vazhdueshme është dhe rezultat i investimeve dhe mbështetjes të Grupit Kastrati. Të gjitha të dhënat dhe parashikimet në një të ardhme shumë të afërt e shohin kompaninë në pozitat e liderit në tregun e sigurimeve. Ofrimi i shërbimeve më bashkëkohore, janë në fokusin e të gjitha kompanive të grupit, i cili vitet e fundit ka investuar dhe vazhdon të investojë në aplikimin e teknologjisë dhe inovacionit, duke i përshtatur ato me standardet europiane. Si pjesë e grupit Kastrati, qëllimi kryesor është rritja e vazhdueshme e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. E thënë ndryshe, ALBSIG nuk synon thjesht të ofrojë produkte dhe shërbime, por të kujdeset në çdo detaj për klientët. Ajo që e diferencon ALBSIG në treg, është pikërisht cilësia e produkteve dhe shërbimeve të ofruara.





ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Youth/Kids, paketa e sigurimit që mbron buxhetin e çdo familje për sigurimin e fëmijëve dhe të rinjve.

Me rritjen e kostove të kujdesit mjekësor dhe mundësinë e lartë të sëmundjeve të papritura, sigurimi i cilësisë së shëndetit të fëmijëve tuaj nuk është diçka që mund të anashkalohet, por një faktor shumë i domosdoshëm për t'u marrë parasysh. Fëmijët meritojnë më të mirën dhe ne si prindër jemi përgjegjës që ata të rriten të shëndetshëm dhe të sigurt. Tani kjo është më e lehtë se kurrë!

Bli online paketën e sigurimit **Youth/Kids** në albsig.al dhe merr policën e sigurimit me një klik, kudo që ndodhesh. Zbuloni më shumë nëpërmjet platformës sonë online albsig.al dhe bëni zgjedhjen tuaj më të mençur sot! Kjo është një thirrje që ju bën Albsig përmes njoftimeve në rrjetet sociale.

Sipas tyre prindërit duan që fëmijët e tyre të mbrohen mirë. Në këmbim, nuk është e pazakontë që ata të binden të marrin sigurime për të cilat dyshohet se kanë nevojë. Me një inspektim më të afërt, megjithatë, bëhet e qartë se nuk kishte asgjë këtu përveç shpenzimeve? Për të minimizuar këto shpenzime është sigurimi Youth/Kids plotësisht i nevojshëm për fëmijët dhe të rinjtë.

Në interes të mos zbrazjes së vazhdueshme të portofolit tuaj, prindërit do të bënin mirë që t'i hidhnin një sy paraprakisht paketës së sigurimit Youth/Kids dhe të zgjedhin këtë produkt sepse është tejet i nevojshëm jo vetëm për fëmijët dhe të rinjtë por edhe për buxhetin e çdo familjeje.





Merrni paketën e sigurimit Youth/Kids menjëherë për ju dhe fëmijët tuaj!

Sigurimi shëndetësor privat mund të ketë shumë përparësi, por për një pjesë gjithashtu shumë i pakapshëm. Për këtë shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, ka hartuar paketat e duhura me çmimet e favorshme për sigurimin e fëmijëve dhe të rinjve. Nga njëra anë, prindërit duhet të kenë parasysh se fëmijët duke kaluar moshën kalojnë dhe në stadi të tjera të sigurimeve shëndetësore private, e cila zbatohet më vonë kur disa sëmundje të mëparshme bëhen të dukshme. Nga ana tjetër, komoditeti që të jep sigurimi privat si qëndrimi në një dhomë private në një spital e shumë benefite të tjera të bëjnë që ky produkt të jetë pjesë e çdo familje shqiptare.

Për të gjithë fëmijët/të miturit në moshën 0-15 vjeç, të cilët frekuentojnë ciklin e arsimit para-universitar, ose të ashtuquajturin arsim të detyrueshëm dhe të rinjtë në moshën 15-25 vjeç, të cilët kryejnë studimet universitare, pasuniversitare ose fakultetin e dytë, ofrohet Polica e Sigurimit "Kids/Youth". Nëpërmjet kësaj police mbulohen shpenzimet për aksidente që ndodhin për shkaqe rastësore, të dhunshme, të menjëhershme dhe të paparashikuara, ku si pasojë e së cilave mund të vërtetohet paaftësia e përkohshme, e përhershme dhe/ose humbja e jetës.

Duke kryer Policën e Sigurimit të "Kids/Youth" mbulohen shpenzimet si pasojë e aksidenteve përgjatë periudhës së mbulimit të përcaktuar në kontratë dhe nëse fëmijët apo të rinjtë e siguruar janë brenda territorit të Shqipërisë. Shpenzimet që njihen kanë aftësi diagnostikuese, stabilizuese apo përmirësuese dhe të cilat janë të nevojshme nga ana mjekësore. Për fëmijët/të rinjtë ofrohet mbulimi i shpenzimeve të trajtimit mjekësor në të gjitha entet shëndetësore për dëmtime që vijnë si pasojë e aksidentit; paaftësinë e përhershme të plotë ose të pjesshme sipas kushteve të sigurimit; vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti. Ndërsa për prindin/kujdestarin ligjor ofrohet mbulimi për paaftësinë e përkohshme sipas kushteve të sigurimit dhe vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti kundrejt pagimit të primit të përcaktuar në Policën e Sigurimit.



+355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL